



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:097709

Datë: 01.03.2024

Numri i dokumentit: 05400540

2022:097710

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.B. nga fshati ...-Komuna Gjilan, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Urim Bajraktari avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S." me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Sh.R., jurist i diplomuar, me objekt kontesti kompensim dëmi, në vlerë prej 4780 euro, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur, me datë 13.02.2024, në praninë të përfaqësuesve të ndërgjyqësve, ndërsa me datë 01.03.2024, jep këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses M.B. nga fshati ...-Komuna Gjilan, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S." me seli në Prishtinë, përmes të cilës ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "S." me seli në Prishtinë, që paditëses t'ia paguaj në emër të dëmit jomaterial dhe material të shkaktuar si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 19.04.2022, shumat me sa vijon: - në emër të dëmit jomaterial për dhimbje fizike shumë e përgjithshme prej 2,000€, -për frikë shumë prej 2,000€, në emër të dëmit material, për – ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë shumë prej 315,00€, për ushqim të përforcuar shumë prej 315,00€ dhe për shërim klimaterik shumë prej 150,00€, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 4780€, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e nxjerrjes së ekspertizave mjekësore e deri në pagesën definitive nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 715,00€.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja, përmes përfaqësuesit të autorizuar av. Urim Bajraktari nga Ferizaj, si në padinë dhe kërkesëpadinë e ushtruar në këtë gjykatë me datë 17.05.2022, në seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare, ka kërkuar nga gjykata që të detyron të paditurën, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial të shkaktuar si pasojë e lëndimeve të pësuar në aksidentin e trafikut të datës 19.04.2022 të i'a paguaj 19.04.2022, shumat me sa vijon: - në emër të dëmit jomaterial për dhimbje fizike shumë e përgjithshme prej 2,000€, -për frikë shumë prej 2,000€, në emër të dëmit material, për –ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë shumë prej 315,00€, për ushqim të përforcuar shumë prej 315,00€ dhe për shërim klimaterik shumë prej 150€, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 4780€, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e nxjerrjes së ekspertizave mjekësore e deri në pagesën definitive nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 715€. Sipas paditëses shkaktari i aksidentit të trafikut, të datës 19.04.2022, është i siguruari i të paditurës, i cili në momentin e aksidentit kishte mbulesë të sigurimit në automjetin e tij tek e paditura, andaj e paditura mban përgjegjësinë për kompensimin e dëmit, për më tepër e paditura e konfirmoj faktin që paditëses i është bërë pagesa e dëmit material për dëmin e shkaktuar në automjet, nga aksidenti ku fajtori ka qenë i siguruar tek këtu e paditura. Gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore është bërë nxjerrja e provës përmes ekspertizave mjekësore dhe atë nga lëmia e ortopedisë dhe psikatrisë, përmes këtyre ekspertive u vërtetua natyra dhe llojet e lëndimeve dhe shqetësimeve që paditësja ka pësuar me rastin e shkaktimit të aksidentit, pra u vërtetua baza juridike e kërkesëpadisë përkatësisht u vërtetua lidhja shkak – pasojë. Eksperti ortoped gjatë seancës gjyqësore sqaroi në mënyrë të qartë që duke marrë për bazë natyrën dhe llojin e lëndimeve tek paditësja, shqetësimet dhe lëndimet fizike kanë mundur të paraqiten pas aksidentit, pra nga kjo arsyeje e njëjta fillimisht ka menduar që nga ky aksident nuk ka pësuar lëndime trupore, mirëpo pas kalimit të një periudhe afërsisht 2 orë nuk është ndier mirë dhe i është dashur me patjetër që të marrë trajtim mjekësor në qendrën mjekësore, siç konstatohet nga raportet mjekësore të bashkangjitura në shkresat e lëndës. Si pasojë e këtij aksidenti të shkaktuar nga i siguruari i të paditurës paditësja ka pësuar lëndime të lehta trupore andaj gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadia të i aprovohet dhe të detyrohet e paditura që të ta kompenson paditësen në emër të dëmit jomaterial për dhimbje fizike shumë e përgjithshme prej 2,000€, -për frikë shumë prej 2,000€, në emër të dëmit material, për – ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë shumë prej 315,00€, për ushqim të përforcuar

shumën prej 315,00€ dhe për shërim klimaterik shumën prej 150,00€, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 4780€, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e nxjerrjes së ekspertizave mjekësore e deri në pagesën definitive nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm si dhe shpenzimet procedurale në shumën prej 715,00€, ashtu që këto shuma të aprovohen në tërësi si të bazuar.

E paditura përmes përfaqësuesit të saj, fillimisht në përgjigjen në padi e datës 30.09.2022 si dhe gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare e ka kontestuar bazën dhe lartësinë e kërkesëpadisë së paditëses me arsyetimin se e paditura në shkresat e lëndës në procedurë të rregullt e ka trajtuar kërkesën për kompensim të dëmit dhe në bazë të provave të paraqitura Komisioni për trajtimin e dëmeve materiale dhe jomateriale e ka trajtuar kërkesën për kompensim dhe të njëjtën e ka refuzuar për shkak se nuk është lajmëruar policia dhe as institucionet shëndetësore por vetëm është plotësuar raporti evropian i aksidentit, ku raporti evropian plotësohet vetëm në rastet kur nuk ka persona të lënduar. Në bazë të nenit 211.3 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor parashihet se: “3. Raporti evropian i aksidenteve nuk plotësohet dhe nuk nënshkruhet në rastin e aksidentit në të cilin ka persona të lënduar ose të vdekur” ndërsa në bazë të nenit 210.1.3 parashihet se: “1. Shoferi, përkatësisht pjesëmarrësi tjetër i përfshirë në aksident të trafikut në të cilin dikush e ka humbur jetën, ose është lënduar, ose është shkaktuar dëm i madh material, e ka për detyrë: 1.3. ta njoftojë Policinë për aksidentin e trafikut, dhe ta presë ardhjen e personave të autorizuar të cilët e bëjnë ekzaminimin e vendit të aksidentit.”. Pra në rast kur në aksident ka të lënduar nuk duhet të plotësohet raporti evropian por të lajmërohet policia dhe institucionet shëndetësore. Kjo parashihet edhe në vetë Raportin Evropian, tek pjesa mbrapa e formularit që i përgjigjet raportit të lëshuar nga Komiteti Evropian i Sigurimeve (CEA), tek paragrafi i parë. Në rastin konkret nuk është lajmëruar Policia e Kosovës dhe as institucionet shëndetësore. Njoftimi i tyre ka për qëllim jo vetëm zbulimin e shkaqeve të aksidentit por edhe sigurimin e ndihmës së menjëhershme për të lënduarit dhe evitimin e çfarëdo keqpërdorimi të mundshëm. Bazuar në të lartëcekurat i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 13.02.2024, ka administruar provat dhe atë si në vijim: Raporti Evropian i aksidentit me numër ... i datës 19.04.2022, Raporti i Qendrës Emergjente ne Ferizaj: me numër ... i datës 19.04.2022, Raporti

mjekësorë i mjekësisë familjare i datës 19.04.2022, Kërkesë për kompensim të demit e datës 21.04.2022, e paditëses, Njoftim mbi kërkesën e demit jo material, i te paditurës i datës 17.05.2022, Ekspertiza mjekësore e datës 15.01.2024, e ekspertit psikiatër Dr. N.M., Ekspertiza mjekësore e datës 16.01.2024, e ekspertit ortoped Dr. B.I.

Faktet

Me leximin e Raportit Evropian i aksidentit me numër ... i datës 19.04.2022, gjykata vërtetoi se me dt. 19.04.2021, koha 16:00 në Ferizaj, lokacioni fshati B., ka ndodhur aksident trafiku mes automjetit A që e drejtonte A.H., i siguruar te Kompania e Sigurimeve “S.” dhe automjetit B që e drejtonte paditësja, i siguruar te Kompania e Sigurimeve “E.”, nga ky aksident është shënuar se kishte lëndime materiale dhe se nuk kishte të lënduar, duke përfshirë lëndimet e lehta.

Me leximin e Kërkesës për kompensim të demit e datës 21.04.2022, e paditëses, gjykata vërtetoi se paditësja me dt. 21.04.2022 i ishte drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensim të demit në automjet.

Me leximin e Njoftimit mbi kërkesën e demit jo material, i te paditurës i datës 17.05.2022, gjykata vërtetoi se e paditura në procedurë jashtëgjyqësore e kishte refuzuar kërkesën e paditëses me arsyetimin se në rast të lëndimeve trupore nuk duhet plotësuar raporti evropian por të lajmërohet policia dhe institucionet shëndetësore.

Me leximin e Ekspertizës mjekësore e datës 16.01.2024, e ekspertit ortoped Dr. B.I. dhe sqarimeve të dhëna në shqyrtim gjyqësor, gjykata vërtetoi se eksperti në bazë të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit të drejtpërdrejt të të dëmtuarit (paditëses), konstaton se bëhet fjalë për këto lëndime trupore: -shtypje dhe përdredhje e unazave të qafës dhe dhembje dhe shtypje e regjionit të shpatullave. Këto lëndime kualifikohen si lëndime të lehta trupore të cilat rezultojnë me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, si pasojë e këtyre lëndimeve e dëmtuara ka përjetuar dhimbje të intenzitetit të rëndë 30 minuta, janë dhembjet nga momenti i aksidentit derisa e dëmtuara ka marrë terapinë kundër dhembjes në qendrën emergjente, të mesëm 14 ditë janë dhembjet të cilat manifestohen gjatë sforcimeve fizike dhe të ultë 6 javë janë dhimbjet të cilat manifestohen për shkak të ndryshimeve klimatike, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor nuk ka, shëmtim trupor nuk ka, përkujdesja nga personi tjetër 7 ditë, ushqim i përforcuar 10 ditë, ushqim të pasur me proteina, vitamine dhe minerale, rehabilitimi dhe terapia fizikale 10 ditë.

Me leximin e Ekspertizës mjekësore e datës 15.01.2024, e ekspertit psikiatër Dr. N.M., gjykata vërtetoi se ekspertja pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezentuar në shkresat e lëndës, konstatoi se paditësja ka pësuar frikë primare, në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimi direkt për integritet të saj fizik, e cila ka zgjatur disa sekonda, në momentin e aksidentit, gjendje e tronditjes psiqike duke e pa veturën në shpejtësi drejt aksidentit, frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur 2 ditë, të intensitetit të mesëm që ka zgjatur 2 javë, shoqëruar me çrregullim gjumi, ankthe etj., të intensitetit të ulët që ka zgjatur për 2 muaj e manifestuar me vështirësi të adaptimit në periudhën e rehabilitimit nga lëndimet etj.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga arsyet në vijim:

Në këtë rast ishte kontestuese baza e kërkesëpadisë së paditëses si dhe lartësia e kërkesëpadisë së paditëses. Gjatë gjithë zhvillimit të procedurës gjyqësore e paditura e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë së paditëses dhe lartësinë e saj duke u bazuar në faktin se nga aksidenti i datës 19.04.2022, në të cilin ishin të përfshirë i siguruari i të paditurës dhe paditësja, ishte lidhur dhe nënshkruar vullnetarisht nga palët raporti evropian i aksidentit, i cili raport sipas dispozitave ligjore i mbulon vetëm dëmet materiale e jo lëndimet trupore.

Natyra juridike e Raportit evropian të aksidentit

Sipas nenit 3, pika 1.64. të Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, termat e përdorur në këtë ligj e kanë këtë kuptim: “Raporti evropian i aksidentit” dokument publik i cili përdoret gjatë shkaktimit të aksidenteve në trafikun rrugor me dëme të vogla materiale, i cili lëshohet nga organi kompetent;

Sipas Formularit të Raportit Evropian të Aksidentit, i cili është i obligueshëm që të mbahet në sirtarin e automjetit të secilit ngasës të veturës në Republikën e Kosovës, shkruan për “Udhëzime për mënyrën e përdorimit të raportit në aksidente të komunikacionit”. Aty thuhet se Ky formular i përgjigjet modelit të raportit të lëshuar nga Komiteti Evropian i Sigurimeve (CEA). Këtë raport jeni të detyruar ta përdorni në të gjitha aksidentet e komunikacionit. Aksidentet e komunikacionit - Çka duhet të bëni? Nëse dikush ka humbur jetën ose është lënduar, duhet që: - Të njoftohet institucioni shëndetësor dhe Policia e Kosovës dhe të qëndrojë në vendin e aksidentit të komunikacionit. Ai/Ajo mund të largohet përkohësisht vetëm për t`u ofruar ndihmë personave të lënduar në aksidente të komunikacionit, të ndërmarrë krejt çka mundet që të mënjanohen

rreziqet e reja që mund të krijohen në vendin e aksidentit, të mundësojë qarkullim normal të komunikacionit, t'i ndërmarrë të gjitha masat që të mos ndryshohet gjendja në vendin e aksidentit dhe të ruhen gjurmët ekzistuese. - Të ndizen të gjithë treguesit e drejtimit, dhe të vendoset trekëndëshi i sigurisë. Nëse është shkaktuar dëm i vogël material: Menjëherë të largohen automjetet nga rruga, të mundësohet zhvillimi i papenguar i komunikacionit, të plotësohet dhe të nënshkruhet "Raporti Evropian" i aksidentit dhe në të njëjtën kohë të shkëmbehen të dhënat personale dhe të dhënat për automjetin (neni 206 i Ligjit mbi sigurinë e komunikacionit rrugor nr. 02/L-70). Shoferët nuk guxojnë ta lëshojnë vendin e aksidentit të komunikacionit derisa të mos e kenë plotësuar dhe nënshkruar "Raportin Evropian të Aksidentit" apo në ndonjë mënyrë tjetër, derisa t'i shkëmbejnë të dhënat personale dhe të dhënat për automjetet. Ju rekomandojmë që pozitat e automjeteve dhe vendi i aksidentit të maten dhe të fotografohen drejtpërdrejt nga një distancë e afërt dhe e largët (dëmtimin e mjeteve, gjurmët e frenimit, bartjes dhe mbeturinave të rëna në rrugë...) dhe gjurmët e rëndësishme (pozitat e rrotave) të shënohen me shkumës. Raporti mbi aksidentin e komunikacionit shërben për ta konstatuar gjendjen faktike dhe nuk do të thotë se ndërmjet palëve është arritur marrëveshja e fajësisë lidhur me aksidentin dhe se me nënshkrim pranohet fajësia. Nëse përshkrimi i aksidentit në raportin evropian nuk mjafton të evidentohen të gjitha elementet e duhura, mund të evidentohen në një fletë shtesë të veçantë.

Sipas nenit 211 (Aksidenti me dëme të vogla materiale) të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, ligj i cili ka vlejtur në kohën e ndodhjes së aksidentit të trafikut të datës 19.04.2022 mes paditëses dhe të siguruarit të paditurës parashihet se: "1. Shoferët - pjesëmarrës në aksident të trafikut në të cilin është shkaktuar dëm i vogël material, janë të obliguar që menjëherë t'i largojnë mjetet nga shiriti rrugor, që ta mundësojnë qarkullimin e papenguar të trafikut dhe ta plotësojnë e ta nënshkruajnë raportin evropian të aksidenteve. 2. Shoferët pjesëmarrës në aksident trafiku e plotësojnë dhe e nënshkruajnë raportin evropian të aksidenteve sipas dispozitës nga paragrafi 1 i këtij neni kur pajtohen për mënyrën se si ka ndodhur aksidenti. 3. Raporti evropian i aksidenteve nuk plotësohet dhe nuk nënshkruhet në rastin e aksidentit në të cilin ka persona të lënduar ose të vdekur. 4. Policia është e obliguar të dalë në vendin e aksidentit të trafikut në të cilin ka ndodhur dëm i vogël material, nëse atë e kërkon njëri nga pjesëmarrësit në trafik dhe atë kur: 4.1. njëri nga mjetet nuk ka targa të regjistrimit ose i njëjti nuk është i siguruar; 4.2. njëri nga mjetet ka targa të huaja të regjistrimit; 4.3. njëri nga shoferët është dukshëm nën ndikim të alkoolit, të drogës ose të barnave që ndikojnë në aftësitë psikofizike; 4.4. njëri nga shoferët nuk posedon patentë shoferi; 4.5. shoferët nuk mund t'i harmonizojnë qëndrimet lidhur me mënyrën dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur aksidenti i trafikut; 4.6. njëri nga shoferët refuzon që t'i ofrojë të

dhënat e veta personale, përkatësisht të dhënat për mjetin; 4.7. njëri nga shoferët e ka lëshuar vendin e aksidentit të trafikut; ose 4.8. në qoftë se shoferi merr pjesë i vetëm në aksident trafiku.”

Kurse sipas nenit 214.1 të këtij ligji parashihet se: “Obligimet e institucionit shëndetësor 1. Në qoftë se institucioni shëndetësor është njoftuar për aksidentin e trafikut apo ka pranuar të lënduar në aksident, e ka për detyrë ta njoftojë menjëherë Policinë.”

Neni 217 i Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor parasheh se: “Detyrimet e policit në vendngjarjen e aksidentit 1. Policia e ka për detyrë të dalë në vendin e aksidentit të trafikut për të cilin është lajmëruar, si dhe në rastin kur gjatë patrullimit has në aksidentin e ndodhur. 2. Polici i cili e bën ekzaminimin në vendin e ngjarjes së aksidentit, e ka për detyrë ta bëjë regjistrimin e pasurisë që mbetet në vendin e ngjarjes, të personit të vdekur ose të lënduar rëndë në aksident trafiku, ta njoftojë kontraktuesin që ta largojë mjetin dhe sendet nga rruga, si dhe të ofrojë ndihmë për ta mbrojtur pasurinë, në qoftë se në vendin e ngjarjes nuk është personi i cili mund ta rimarrë atë pasuri. 3. Pavarësisht prej dëmit të shkaktuar dhe prej shkallës së lëndimit, pas daljes në vendin e aksidentit për të cilin Policia është lajmëruar nga pala e përfshirë në aksident, Polici është i obliguar të bëjë raport mbi aksidentin. 4. Nëse me rastin e ekzaminimit të vendit të aksidentit me dëme të vogla materiale nuk ka nevojë për skicim dhe matje, mjafton fotografimi nga vendi i ngjarjes dhe deklaratat e dëshmitarëve dhe shoferëve.”

Sipas nenit 210, par. 1, nënpar. 1.3 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor parashihet se: “1. Shoferi, përkatësisht pjesëmarrësi tjetër i përfshirë në aksident të trafikut në të cilin dikush e ka humbur jetën, ose është lënduar, ose është shkaktuar dëm i madh material, e ka për detyrë: 1.3. ta njoftojë Policinë për aksidentin e trafikut, dhe ta presë ardhjen e personave të autorizuar të cilët e bëjnë ekzaminimin e vendit të aksidentit,”

Nga i tërë dokumentacioni që e ka administruar gjykata për këtë çështje juridike, konstaton se paditësja dhe i siguruari i të paditurës kanë lidhur vullnetarisht me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë pa asnjë formë të dhunës, mashtrimit apo kërcënimit raportin evropian të aksidentit, në këtë raport evropian të aksidentit te rubrika e të lëndadurimit, duke përfshirë edhe lëndimet e lehta është rumbullakuar shprehja “Jo”, që i bie se palët kanë pranuar se nga ky aksident i trafikut nuk ka pasur të lënduar. Aksidenti i trafikut sipas të dhënave që përshkruhen në raportin evropian të aksidentit kishte ndodhur me datë 19.04.2022, rreth orës 16:00, lokacioni fshati B.-Ferizaj. Për ti vërtetuar këto lëndime dhe natyrën e tyre gjykata, sipas propozimit të autorizuarit të paditëses, ka caktuar marrjen provës me ekspertizë mjekësore nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë dhe

për ekspert ka caktuar (sipas propozimit të palës) ekspertët e licencuar mjekësorë, Dr. B.I., Ortoped-Traumatolog dhe Dr. N.M.-Psikiatër, të cilët kanë dhënë mendimin e tyre profesional duke u bazuar në dokumentacionin mjekësor që gjendet në shkresat e lëndës. Eksperti mjekësor nga lëmia e ortopedisë me anë të ekspertizës, pas ekzaminimeve përkatëse kanë ardhur në përfundim se paditësja, ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe atë: në bazë të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit të drejtpërdrejt të të dëmtuarit (paditëses), konstaton se bëhet fjalë për këto lëndime trupore: -shtypje dhe përdredhje e unazave të qafës dhe dhembje dhe shtypje e regjionit të shpatullave. Këto lëndime kualifikohen si lëndime të lehta trupore të cilat rezultojnë me dëmtim të përkohshëm të shëndetit. Duke qenë se për të paditurën gjatë gjithë procedurës ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë së paditëses, i autorizuari i të paditurës në shqyrtimin gjyqësor nuk parashtrroi pyetje ndaj ekspertit ortoped dhe as nuk paraqiti vërejtje, ndërsa i autorizuari i paditëses i parashtrroi disa pyetje rreth të cilave mori përgjigje nga eksperti ortoped.

Përkundër që ekzistojnë në shkresat e lëndës raporti i ekspertit ortoped dhe raporti i ekspertit psikiatër, kjo gjykatë gjeti se kërkesëpadisë së paditëses i mungon baza juridike gjë që bëri që ekspertizat mjekësore të jenë jorelevante lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridiko-civile. Sipas dispozitës së nenit 211, paragrafi 3 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor i Republikës së Kosovës parashihet se: “3. Raporti evropian i aksidenteve nuk plotësohet dhe nuk nënshkruhet në rastin e aksidentit në të cilin ka persona të lënduar ose të vdekur.”. Është rregull e përgjithshme ligjore sipas nenit 217.3 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, e cila vlen në çdo rast se kur ka aksident trafiku me të lënduar edhe nëse shfaqen lëndimet më vonë p.sh pas disa orëve siç mund të jetë edhe rasti konkret, Policia e Kosovës është organi kompetent shtetëror i cili duhet ta hartojë raportin e aksidentit, në të cilin përshkruhen të dhënat e automjeteve, pronarëve, vozitësve, vendi, koha e aksidentit, bëhen skicat nga vendi i ngjarjes, përshkruhet se si ka ndodhur aksidenti me fajin e cilës njësi dhe konstatohen personat e lënduar nga aksidenti i trafikut. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja nuk kishte hapur rast në Polici lidhur me aksidentin e trafikut të datës 19.04.2022, por ishte mjaftuar me raportin evropian të aksidentit të cilin e kishte nënshkruar me palën tjetër, përkatësisht të siguruarin e të paditurës, edhe pse ndaj paditëses pas rreth 2 ore ishin shfaqur simptoma të lëndimeve për të cilat ishte detyruar të paraqitej në Qendrën Emergjente në Ferizaj për trajtim mjekësor. Në nenin 214 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor parashihen obligimet e institucionit shëndetësor, kur njoftohet institucioni shëndetësor për aksidentin e trafikut apo ka pranuar të lënduar në aksident. Në këtë dispozitë ligjore parashihet qartë se:“Obligimet e institucionit shëndetësor 1. Në qoftë se

institucioni shëndetësor është njoftuar për aksidentin e trafikut apo ka pranuar të lënduar në aksident, e ka për detyrë ta njoftojë menjëherë Policinë.”, ndërsa nga shkresat e lëndës nuk rezulton se institucioni shëndetësor të kishte njoftuar Policinë ashtu siç kërkohet me këtë dispozitë ligjore lidhur me këtë aksident të trafikut, edhe pse e kishte pasur detyrim. “Ignorantia legis non excusat” është frazë latine që rrjedhë nga e drejta romake që ka kuptimin “mosnjohja ligjit nuk e justifikon askënd”, ndërlidhur me rrethanat e rastit konkret paditësja është dashur të hapte rast në Polici pasi që te ajo ishin shfaqur simptomat e lëndimeve trupora nga aksidenti i datës 19.04.2022 dhe për gjykatën është i papranueshëm justifikimi se nuk e ka bërë një gjë të tillë. Ligjdhënësi me rastin e parashikimit të institutit të Raportit evropian të aksidentit garanton një siguri të caktuar juridike në situata dhe rrethana të caktuara dhe kontribuon në besimin publik në gjykata, kurse një nga komponentët thelbësorë të sundimit të ligjit është siguria juridike. Poashtu me rastin e parashikimit të rregullës së përgjithshme ligjore se për çdo aksident trafiku me persona të lënduar duhet të hartohet Raporti i aksidentit nga ana e Policisë së Kosovës si organ kompetent shtetëror është garantuar siguria juridike për të gjitha rastet pa përjashtim. Kjo gjykatë e vendosë theksin përfundimisht se lëndimet trupore të paditëses nga aksidenti nuk ishin kontestuese asnjëherë nga e paditura dhe këto u konstatuan edhe me leximin e raporteve të ekspertizave mjekësore nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë por siç u pa kërkesëpadia e paditëses nuk ka bazë juridike andaj për këtë arsye u deshtë të refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses. Meqë kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar, irrelevante mbetet lartësia e kërkesëpadiës.

Gjykata fillimisht i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ e cila ka theksuar vazhdimisht se një nga komponentët thelbësorë të sundimit të ligjit është siguria juridike (shih rastin e GJEDNJ-së BRUMĂRESCU kundër Rumanisë, kërkesa nr.28342/95, paragrafi 61, e cila, ndër të tjera, garanton një siguri të caktuar në situata juridike dhe kontribuon në besimin publik në gjykata (shih, mutatis mutandis, rastin NEJDET ŞAHİN dhe PERİHAN ŞAHİN kundër Turqisë, Aktgjykim i 20 tetorit 2011, paragrafi 56).

Gjykata i vlerësoi të gjitha pretendimet tjera të palëve mirëpo gjeti se të njëjtat nuk kanë ndonjë ndikim për vendosjen ndryshe të këtij kontesti.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi konform nenit 450 të LPK, në të cilin parashihet se: “Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.”, poashtu sepse pala e paditur si palë gjyqfituese nuk i kërkoi-specifikoi shpenzimet procedurale.

Andaj, duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, e konform nenit 143 të LPK gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Datë 01.03.2024

Gjyqtari

Armend Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit e Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.